



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 112102-11415
Dt: 22.07.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 8 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, duke vendosur lidhur me rekomandimin e komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për persona me sëmundje të rënda, me datën 22.07.2024 miraton këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për subvencionimin e shpenzimeve për shërimin e dhjetë (10) qytetarëve të Komunës së Gjakovës me sëmundje të rënda.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të realizon procedurën e kryerjes së pagesave në vlerë të përgjithshme prej 5000€ nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe pagesën e tyre të realizon në xhirlogaritë e dhjetë (10) personave sipas rekomandimit të komisionit të DSHMS-së.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e komisionit me të dhënat e përfituesve.
4. Ky vendim hyr në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Gjakovës.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës së Gjakovës